

Reagimi i plotë i Bordit të përkohshëm i Postës së Kosovës:

*Të nderuar media,*

*Bordi i Përkohshëm i Postës së Kosovës ka vendosur që ta paditë portalin kallxo.com për shpifje dhe fyerje në dokumentarin e mbrëmshëm të fabrikuar me përmbajtën kallxo sipas tekeve të portalit.*

*Padia për shpifje ndaj kallxo.com, do të përmbajë të vërtetën e vetme të argumentuar si me poshtë:*

*1. Bordi i Përkohshëm i Drejtorëve dhe Menaxhmenti aktual, nuk është kompensuar asnjë centë nga Komitetet e IFJB-së të Postës së Kosovës. Pra portali kallxo.com ka shpifur 12 mijë herë dhe ka kallxuar rrena dhe gënjeshtër.*

*2. Bordi i Përkohshëm i Drejtorëve, nuk ka pranuar "çokolada" sipas fabrikimit të portalit kallxo.com.*

*3. Leonard Shabanaj, nuk qenë dhe as nuk është anëtar i organeve udhëheqëse të AAK-së.*

*4. Fadil Aliu, nuk ka qenë dhe nuk është anëtar i organeve vendimmarrëse të LDK – së, përveç kur ishte kandidat për deputet në zgjedhjet e vitit 2017.*

*5. Bordi i Përkohshëm i Drejtorëve, ka të gjitha opinionet ligjore të Njesisë për Monitorimin e Ndërmarrjeve Publike, Opinionin ligjor të Sekretarit të Bordit, se procedurat dhe kriteret janë përmbushur me rastin e përzgjedhjes së zyrtarëve të lartë përfshirë Kryeshefin Ekzekutiv.*

*6. Xhevdet Smakiqi, nuk i takon asnjë partie politike dhe po ashtu sipas nenit 17.2 të Ligjit për NP, ka përmbushur kriteret ligjore edhe profesionale me përvoje menaxheriale mbi 15 vite.*

*7. Titujt dhe vlerësimet në rolin e gjykatave apo organeve shtetërore për konstatime përfundimtare të portalit kallxo.com, mbi monopolin e të vërtetës së tyre, do të vërtetohen si shpifje dhe fyerje ndaj Bordit të Përkohshëm të Drejtorëve në një proces gjyqësor të Kosovës që do të iniciojmë së shpejti.*

*I garantojmë aksionarit dhe kolegëve të Postës së Kosovës, por dhe opinionit publik se në 5 muajt mandat, Bordi i Përkohshëm i Drejtorëve, së bashku me Menaxhmentin, kanë ulur shpenzimet operative në të gjitha nivelet, përfshirë këtu zbritjen e pagave për stafin rreth 250 mijë euro vjetore, për dallim nga ish bordet dhe menaxhmentet që janë mbështetur direkt me mbi 2.5 milion euro nga Qeveria.*

*Po ashtu shpenzimet tjera operative, si dhe kemi ngritur të hyrat vetanake përmes veprimeve të Menaxhmentit të ndërmarrjes edhe pse kemi vepruar në kushte pandemie me staf esencial.*

*Bordi i Përkohshëm i Drejtorëve, ka ofruar çdoherë transparencën ndaj mediave, përfshirë këtu edhe portalit kallxo.com, duke ftuar në monitorim por që i njëjti portal është përcaktuar për shpifje dhe fyerje ndaj nesh, prandaj do të përballet me padi gjyqësore.*

*Me respekt!*

*Bordi i Përkohshëm i Postës së Kosovës Sh.A.*

*Prishtinë*